

Prof. Dr. Migena Leskoviku

Propozuar nga Instituti i Studimeve Evropiane (ISE), Universiteti i Tiranës.

Aktualisht mban postin e Përgjegjëses së Departamentit të Legjislacionit dhe Politikave të BE-së, Instituti i Studimeve Evropiane (ISE), Universiteti i Tiranës. Ka përfunduar studimet universitare dhe ato pasuniversitare në Drejtësi, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Gjithashtu, ka kryer studimet master në “Public Administration”, program master i përbashkët mes Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Nebraskës (SHBA). Aktualisht mban titullin akademik më të lartë: “Profesor”.

Znj. Leskoviku ka një përvojë të gjatë akademike që prej 1998 (25 vite), në mësimdhënie në Universitetin e Tiranës dhe në disa universitete të tjera publike apo jopublike në vend. Ka mbajtur pozicione drejtuese akademike si: Dekane, zv/Dekane apo Përgjegjëse e Departamentit të së Drejtës Publike në Fakultetin Juridik, UET. Gjithashtu ajo ka përvojë pune edhe në administratën publike si edhe ka marrë pjesë në aktivitete të zhvilluara në bashkëpunim me institucione të administratës publike.

Prof.Dr. Migena Leskoviku ka eksperiencë të gjatë si eksperte/konsulente për agjenci e organizata të ndryshme lokale dhe organizata ndërkombëtare. Gjithashtu, ajo ka marrë pjesë në disa projekte brenda dhe jashtë vendit, si këshilltare ligjore apo eksperte lokale ose ndërkombëtare për çështje që lidhen me të drejtat e njeriut, demokracinë, ligjin, integrimin evropian, reformat ligjore, etj.

Prof.Dr.Migena Leskoviku ka marrë pjesë në disa programe shkëmbimi akademike dhe programe trajnimi në SHBA dhe vende të BE-së, dhe si *profesor vizitor* në institucione akademike jashtë vendit. Ajo është autore e mjaft artikujve shkencorë të botuar në revista të njohura shkencore brenda dhe jashtë vendit, si dhe bashkëautore e disa botimeve, studimeve, manualeve në shqip dhe anglisht, botuar brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të bashkëpunimeve të ndryshme vendore apo ndërkombëtare, ku një pjesë e tyre i dedikohet administratës publike dhe reformimit të saj. Gjithashtu, në eksperiencën e saj të gjatë 25 vjeçare akademike e profesionale, ajo ka marrë pjesë në mjaft konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe është anëtare e Bordit Editorial të dy revistave shkencore ndërkombëtare, si dhe anëtare në disa borde dhe komisione.

Ajo ka një angazhim të gjatë me shoqërinë civile dhe është aktive në bashkëpunime me disa organizata të shoqërisë civile shqiptare si anëtare bordi, konsulente, eksperte në fushën e legjislacionit, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut, administratën publike, integrimin evropian dhe reformat kryesore kushtetuese-ligjore. Është *anëtare e Këshillit Kombëtar të Integritimit Evropian (KKIE)*, si dhe ka qenë Anëtare e Bordit Këshillimor në kuadër të Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut, të ngritur nën kujdesin dhe mbikqyrjen e Kuvendit të Shqipërisë në zbatim të *Strategjisë Kombëtare për Edukimin Ligjor të Publikut 2019 - 2023*.

Prof.Dr. Migena Leskoviku është staf akademik në Universitetin e Tiranës (UT) dhe aktualisht mban pozicionin e Përgjegjëses së Departamentit të Legjislacionit dhe Politikave të BE-së, në Institutin e Studimeve Evropiane, Universiteti i Tiranës.

Prof. Dr. Migena Leskoviku

Proposed by the Institute of European Studies (ISE), University of Tirana.

Prof. Dr. Migena Leskoviku currently serves as the Head of the Department of Legislation and EU Policies at the Institute of European Studies, University of Tirana. She completed her undergraduate and postgraduate studies in Law at the Faculty of Law, University of Tirana, and obtained a Master's degree in Public Administration through a joint program with the University of Nebraska, USA.

She holds the highest academic title: "Professor." With 25 years of academic experience, she has been involved in teaching at the University of Tirana and several other public and private universities. She has held various academic leadership positions, including Dean, Vice Dean, and Head of the Department of Public Law at the Faculty of Law, UET. She also has experience in public administration and has participated in activities in collaboration with public administration institutions.

Prof. Leskoviku has extensive experience as an expert and consultant for various local and international organizations. She has participated in several projects domestically and abroad as a legal advisor or local and international expert on issues related to human rights, democracy, law, European integration, and legal reforms. She has taken part in various academic exchange programs and training initiatives in the USA and EU countries and has served as a visiting professor at academic institutions abroad. She is the author of numerous scientific articles published in reputable journals, both nationally and internationally, and has co-authored several publications, studies, and manuals in both Albanian and English, focusing on public administration and its reform. Throughout her 25-year academic and professional career, she has participated in many national and international scientific conferences and serves on the editorial boards of two international scientific journals, as well as on various boards and committees.

Prof. Leskoviku is actively engaged with civil society and collaborates with several Albanian civil society organizations as a board member, consultant, and expert in legislation, the rule of law, human rights, public administration, European integration, and major constitutional and legal reforms. She is a member of the National Council for European Integration and has served on the Advisory Board of the National Network for Legal Education, established under the auspices of the Albanian Parliament, in line with the National Strategy for Public Legal Education 2019-2023.

She continues to contribute significantly to the academic community at the University of Tirana, focusing on the intersection of law and European policies.